

29570; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.P01162, FDH-35263.

### Miloš (Nikodin) Bradić

(12.01.1963, serb nga Beogradi, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Miloshi punonte në SHPB Vozhdovac, Beograd. Nga marsi i vitit 1998, gjendej në terren në Kosovë. Kohë pas kohe e vizitonte familjen, kurse për herë të fundit familjarët e kishin parë të gjallë më 17.09.1998. Miloshi ka pësuar më **22.09.1998** në fshatin **Oshlan/Ošljane**, nga një bombë që e kishte aktivizuar një vendas [të shikohet regjistrimi më sipër]. Familjarët e varrosën më 25.09.1998, në Varrezat Qendrore në Beograd.

**Burimet:** deklarata K.B, FDH-26348; SMIP, *Teroristički...*, III, 513; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 16; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; M. Sekulić, *Beograd...*, 26-27; Komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, Certifikata nga libri amzë i të lindurve, 23.09.1998, FDH-11450; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, Beograd, 2006, III, 336.

### Bislim (Kamber) Imeri

(1.04.1975, shqiptar nga Oshlani/Ošljane, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, i pamartuar, i papunë, pjesëtar i UÇK-së)

Bislimi mori pjesë në mbrojtjen e fshatit Oshlan/Ošljane më **22.09.1998**, kur forcat serbe kishin filluar sulmin ndaj UÇK-së në zonën e **Çiçavicës/Čičavica**. Po atë ditë, në pyllin e fshatit [**Oshlan/Ošljane**], Bislimi u qëllua me pushkë snajperi. Trupin e tij e kishin gjetur babai i tij Kamberi dhe kushëriri Rasimi. Bislimin e varrosën katër ditë më vonë, pas tërheqjes së forcave serbe. Pas lufte, në muajin qershor të vitit 1999, mbetjet mortore të Bislimit u riarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Shipol/Šipolje [Mitrovicë/Kosovska Mitrovica].

**Burimet:** deklarata R.G, FDH-19403; *Serb Forces Continue Burning Vushtrri Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 24.09.1998, FDH-29570; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.P01162, FDH-35263.

### Mustafë (Shaqir) Shyti

(10.10.1945, shqiptar nga Oshlani/Ošljane, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, mësues, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### Sheremet (Bajrush) Sheremeti

(20.03.1961, shqiptar nga Oshlani/Ošljane, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, elektro-inxhinier, dy fëmijë)

Mustafën e kanë arrestuar disa herë për shkak të veprimtarisë së tij politike. Për herë të parë u arrestua në vitin 1967, kurse për herë të fundit në muajin prill të vitit 1998. Ai ishte aktivist i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. I kishte mbaruar studimet në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Shkruante poezi dhe publikonte vjersha. I kishte katër vajza dhe dy djem. Sheremeti punonte në ndërmarrjen *Llankos* në Vushtrri/Vuçitrn. Jetonte me bashkëshorten Lumnijën, fëmijët dhe familjen e të vëllait Nezirit, si dhe babanë Bajrushin.

Në datën 21.09.1998, Bajrushin, Sheremeti dhe Neziri i kishin larguar gratë dhe fëmijët nga Oshlani/Ošljan, ndërsa në shtëpi, përveç Bajrushit dhe Sheremetit, ndenjën Tahiri dhe nipat Sokoli dhe Dritoni, ndërsa Neziri aderoi në UÇK. Në datën **22.09.1998**, forcat serbe kishin hyrë në fshat [**Oshlan/Ošljane**]. Sheremeti dhe të tjerët ikën në pyll, në vendin e quajtur *Kroi i Sokolave/Potok sokolova*. Atje u takuan me Mustafën, Nezirin dhe ushtarët e tjerë të UÇK-së. Policët serb i zbuluan dhe ndaj tyre hapën zjarr. Mustafa dhe ushtarët e tjerë iu kundërpërgjigjën zjarrit, kurse Sheremeti dhe ushtarët e tjerë të paarmatosur ikën. Gjatë shkëmbimit të zjarrit, Mustafa u plagos rëndë. Ai ndërroi jetë dy ditë më vonë në shtëpinë e kushëririt Hasan Shyti.

Pas një kohe të shkurtër, policët e kishin gjetur Sheremetin në vendin ku ishte fshehur dhe u përpoqën për ta mposhtur, me ç' rast Sheremeti njërit prej tyre ia rrëmbeu pushkën, ndërsa polici tjetër kishte qëlluar mbi të dhe e kishte vrarë. Të nesërmen, Neziri, Tahiri, Bajrushin, Sokoli dhe Dritoni e bartën trupin e Sheremetit në oborrin e shtëpisë familjare, ndërsa një ditë më vonë e varrosën në varrezat e fshatit. Pas lufte,